



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, më 07.09.2021

NJOFTIM

ULET VIJA E FINANCIMIT PËR MASAT MBËSHTETËSE DIREKTE TË VITIT 2021

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural njofton uljen e vijës së financimit për aplikimet sipas masave mbështetëse të fermerëve dhe sipas listave të shpallura, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Udhëzimin Nr. 3 datë 26.02.2021, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural” i MBZHR dhe MFE, si dhe Urdhrit të Ministrit nr. 331, datë 04.08.2021, “Për rialokimin e fondit të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2021”

Njoftimi mbi uljen e vijës së financimit për “**Listat e Aplikimeve të Kualifikuara**”, të cilat gjenden në faqen zyrtare: www.azhbr.gov.al, për masa mbështetëse direkte, financuar nga Programi Kombëtar, viti 2021.

Agropikat janë në gatishmëri për dhënie informacioni të aplikantëve të cilët janë brenda vijës së financimit.

Më poshtë po ju njoftojmë numrin rendor të aplikantëve që janë përfshirë mbi vijën e financimit.

- **Masa 4:** Mbjellje Bimë Aromatike dhe medicinale –Vija e financimit ishte në numrin rendor **104**, për kodin e aplikimit me numër **1774** - Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor **113**, për kodin e aplikimit me numër **1849**.

Afati i dorëzimit të dokumenteve shtesë për aplikantët që ndodhen mbi vijën e financimit është deri më datë **22.09.2021**. Dorëzimi përtej këtij afati do të rezultojë me skualifikim të aplikimit.